


# Të drejtat e pacientëve shkurtimisht

Pacientet ose pacientët e informuar mirë, të cilët i njohin të drejtat e tyre, mund të marrin pjesë në mënyrë aktive në trajtimin e sugjeruar dhe të hyjnë në një marrëdhënie besimplotë me mjekun dhe personelin infermieror.



## 1. E drejta për sqarim

Ju keni të drejtën, për t'u informuar në mënyrë të qartë dhe të arsyeshme rreth gjendjes suaj shëndetësore, kontrolleve të planifikuara dhe trajtimeve, avantazheve të parashikuara dhe çdo rreziku të ngutshëm, parashikimit si dhe rreth aspekteve financiare.

Gjatë hyrjes në një institucion shëndetësor ju merrni informacione me dokument ose në formë elektronike për të drejtat dhe detyrimet tuaja si dhe për kushtet e qëndrimit tuaj.

## 2. Dhënia e lirë dhe në mënyrë të shpjegueshme e pëlqimit

Në rastin e aftësisë së gjyqimit (nëse vlerësoni një situatë dhe merrni vendime konsekuente), një trajtim duhet kryer vetëm, nëse ju – nëse jeni i rritur apo minoren – keni dhënë pëlqimin në mënyrë të lirë (pa presion ose detyrim) dhe të shpjegueshme (me dijeni të plotë të çështjes).

## 3. Deklarata e vullnetit të pacientit dhe përfaqësimi i pacientëve në rastin e paftësisë për të gjykuar

Ju mund të shkruani një deklaratë vullneti të pacientit, ku të përcaktoni, se cilat trajtime mjekësore pranoni dhe nuk doni të pranoni dhe të caktoni një përfaqësim për rastin kur e humbisni aftësinë tuaj për të gjykuar. Ky person mund të vendosë për ju (kjo do të thotë, në përputhje me vullnetin tuaj të supozuar si dhe interesat tuaja) në

lidhje me trajtimin, nëse ju nuk jeni më në gjendje për këtë.

## 4. Zgjedhja e lirë e kujdestarit për kujdesin shëndetësor dhe/ose e institucionit të kujdesit shëndetësor

Nëse ju mund ta zgjidhni në mënyrë të lirë kujdestarin për kujdesin shëndetësor ose institucionin e kujdesit shëndetësor, kjo varet kryesisht nga modeli juaj i zgjedhur i sigurimeve shëndetësore. Një trajtim spitalor në një klinikë private ose jashtë kantonit ndoshta nuk merret plotësisht përsipër nga sigurimi juaj bazë. Prandaj në çdo rast duhen lexuar me saktësi kushtet e përgjithshme të punës të sigurimit tuaj bazë dhe atij shtesë.

Në rastin e një trajtimi ambulator ju mund të zgjidhni lirisht kujdestarin për kujdesin shëndetësor, të cilin dëshironi ta kontaktoni, përveç se modeli i sigurimit të zgjedhur prej jush e kufizon këtë zgjedhje (p.sh. modelin e mjekut të familjes ose rrjetin e mjekëve).

Katalogu dhe cilësia e shërbimeve, të cilat merren përsipër nga sigurimi bazë i detyrueshëm, mbeten të njëjta.

## 5. Marrja e masave të detyrueshme

Çdo trajtim kundër vullnetit tuaj ose pavarësisht qëndresës suaj vlen si marrje mase e detyrueshme, pavarësisht nga fakti, nëse bëhet fjalë për një masë të kufizuar ose për një trajtim pa dhënien e pëlqimit.

Ju duhet të jeni në gjendje, për të pranuar në mënyrë të pavarur trajtimet, të cilat ju sugjerohen: kjo do të thotë duke u bazuar në informacione të besueshme dhe pas një vlerësimi të kujdesshëm. Marrja e masave duhet të përkohet me vlerat tuaja personale.

Në parim, çdo zbatim me detyrim është i ndaluar; megjithatë në mjekësi ka situata, në të cilat zbatimi i masave të detyrueshme është i pashmangshëm (p.sh. në një klinikë psikiatrike). Por për këtë vlejë kushte të rrepta paraprake të përcaktuara me ligj.

---

## 6. E fshehta e profesionit në fushën e shëndetësisë

Ju keni të drejtën për faktin, që të gjitha të dhënat tuaja të trajtohen në mënyrë të besueshme. Kujdestarët për kujdesin shëndetësor janë të detyruar, që e fshehta e profesionit që emërtohet edhe si sekreti i mjekut, të mbrohet. Ata duhet ta mbajnë për vete gjithçka, çfarë zbulojnë gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre.

Pavarësisht nga përjashtimet e rregullta ligjore ata nuk duhet të përcjellin më tej asnjë informacion te palët e treta pa dhënien e pëlqimit tuaj. E fshehta e profesionit vlen edhe midis kujdestarëve për kujdesin shëndetësor.

E fshehta e profesionit synon mbrojtjen e privatësisë suaj dhe mbrojtjen e kujdestarëve, të cilët duhet të heshtin për gjërat që u janë besuar atyre.

---

## 7. E drejta për të parë dosjen e pacientëve

Ju keni të drejtë të shikoni dosjen tuaj të pacientit. Në varësi të kantonit, ju mund të merrni në dorëzim dokumentet në origjinal ose si kopje dhe t'ia përcillni ato më tej personit të kualifikuar të kujdesit shëndetësor që keni zgjedhur.



---

## 8. eHealth dhe dosja elektronike e pacientëve

Ju keni të drejtën për një dosje elektronike të pacientit (DEP). Në këtë mënyrë ju mund të ndikoni në administrimin e të dhënave tuaja shëndetësore dhe të keni akses në informacionet tuaja mjekësore.

DEP mbledh kopjet dixhitale të të dhënave më të rëndësishme, të cilat janë ruajtur nga shërbimet tuaja shëndetësore. Kështu thjeshtohet shkëmbimi midis kujdestarëve për kujdesin shëndetësor dhe gjetjes së përbashkët të vendimit. Pikërisht si ju, edhe kujdestarët për kujdesin shëndetësor, të cilët ju trajtojnë, mund t'i shohin në çdo kohë këto informacione. DEP-ja juaj është e mbrojtur dhe e siguruar. Ajo ju përket juve dhe ju vendosni në mënyrë të lirë, se kush duhet të ketë akses në të.

---

## 9. Gabimi i trajtimit

Ju keni të drejtë të trajtoheni me kujdesin e nevojshëm mjekësor. Në rastin e një gabimi të trajtimit ju keni të drejtën, për të kërkuar një sqarim nga personi i specializuar që ju ka trajtuar. Ju mund të bëni të gjitha pyetjet, për të kuptuar, se çfarë ka ndodhur. Ju keni edhe të drejtën, për të marrë një mendim të dytë mjekësor dhe për mbështetje të mëtejshme të kontaktoni me një organizatë për të drejtat e pacientëve.

Rreziku zero nuk ekziston në mjekësi; çdo trajtim mjekësor mbart rreziqe. Nëse pas një trajtimi shfaqen komplikacione, kjo nuk do të thotë automatikisht se personi i kualifikuar i kujdesit shëndetësor ka bërë një gabim dhe mund të bëhet përgjegjës.

---

## 10. E drejta për ndihmë dhe këshillim

Gjatë të gjithë kohës së qëndrimit në një institucion shëndetësor ju keni të drejtën për përkrahje. Ju keni të drejtën, për t'u mbështetur nga të afërmit tuaj dhe të mbani kontakt në mjedisin tuaj përreth. Ju mund të thërrisni edhe një person shoqërues të jashtëm, për shembull nga një organizatë pacientësh.

Nëse trajtoheni në shtëpi, një person i afërt mund t'ju ndihmojë dhe t'ju shoqërojë. Ai mund t'ju ndihmojë rregullisht në rutinën e jetës suaj të përditshme.

---

## 11. Dhurimi i organeve dhe indeve

Ju keni të drejtën, për të vendosur për jetën, nëse dëshironi të dhuroni organet tuaja për transplantime.

Të paktën deri në vitin 2026 vlen e ashtuquajtura zgjidhje e miratimit, që do të thotë: Organet dhe indet e një personi të ndarë nga jeta duhet të merren vetëm atëherë, nëse ai ka dhënë pëlqimin. Siç pritet, duke filluar nga viti 2026 në Zvicër do të zbatohet modeli i zgjidhjes së zgjeruar të kundërshtimit, që do të thotë: Çdo person vlen në parim si dhurues i organeve dhe indeve, përveç atij që ka deklaruar gjatë jetës së tij që nuk dëshiron të dhurojë. Nëse dikush nuk ka deklaruar me vullnetin e tij gjatë jetës, atëherë për këtë vendosin të afërmit duke marrë parasysh dëshirën e supozuar të të ndjerit. Nëse personi nuk ka deklaruar me vullnetin e tij dhe të afërmit nuk janë të arritshëm, atëherë organet dhe indet nuk duhet të merren.

Dhurimet e organeve, indeve ose qelizave janë pa pagesë; tregtimi i tyre është i ndaluar.

---

## 12. Shoqërimi i të ndjerit

Ne të gjithë kemi të drejtën për një fund jete të denjë dhe në paqe. Pacientet dhe pacientët duhet të marrin trajtime dhe të shoqërohen në fazën e fundit të jetës, të cilat janë të arsyeshme nga pikëpamja mjekësore dhe që ju përshtaten dëshirave dhe nevojave të

tyre. Ato ndjekin synimin për të marrë ose për të përmirësuar deri në fund cilësinë themelore për jetën.

Njerëzit në fund të jetës kanë një të drejtë për përkujdesjen për të lehtësuar dhimbjet, pra ndër të tjera për lehtësimin e simptomave dhe dhimbjeve, përkujdesjen komode dhe, në rast se dëshirohet, për shoqërim të përshtatshëm, psikologjik, shoqëror dhe shpirtëror. Ata gjithashtu kanë të drejtë të shoqërohen kur shkojnë tek ofruesit e shërbimit shëndetësor.

---

## 13. Detyrimet e pacientëve

Si paciente ose pacient ju keni të drejta, por edhe detyrime, si p.sh. ndjekja e trajtimit të urdhëruar dhe informimi i kujdestarëve për kujdesin shëndetësor që kujdesen për ju për çështje të rëndësishme që kanë të bëjnë me shëndetin tuaj. Respektimi i këtyre detyrimeve kontribuon në mënyrë thelbësore për cilësinë e trajtimit tuaj.


Falë pjesëmarrjes suaj aktive, e cila bazohet në komunikimin, besimin dhe respektin e ndërsjellë, kujdestarët për kujdesin shëndetësor të fushës së shëndetësisë dhe sociale mund t'ju ofrojnë një trajtim që përkon në mënyrën më të mirë të mundshme me vlerat dhe dëshirat tuaja.

---

## Dëshironi më tepër informacione, keni nevojë për ndihmë ose për një këshillë?



Kërkoni broshurën tonë të hollësishme "Të drejtat e pacientit në pamje të përgjithshme" ose drejtohuni seksionit të shëndetësisë së kantonit tuaj:



Një masë e kantoneve të Bernës, Fraiburgut, Gjenevës, Jurës, Nojenburgut, Tesinit, Vadit dhe Valisit